



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 185/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës A.nr. 185/2025 e datës 24.01.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, më datë 24.01.2025 ka parashtruar ankesë ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), lidhur me pjesëmarrjen anëtarit të KQZ-së, Ibrahim Selmanaj në tubim politik zgjedhor në fshatin Ratishë e Ulët dhe të Epërm të Komunës së Deçanit.

Me datë 26.01.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesën me Nr. Protokolli 185/4 për tërheqjen e ankesës Anr.185/2025 të datës 24.01.2025, kundër subjektit politik AAK, duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-së, duke kërkuar nga PZAP që ankesa me nr.185, të tërhiqet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.185/2025 më datën 27.01.2025.

